



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME”
DIBËR

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data: 03.05.2023

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION”sh.p.k me të dhënat si më poshtë:

Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION”sh.p.k me NIPT K47103804L me adresë në Elbasan Gramsh, GRAMSH SPORTI.

Shoqëria “LIS KONSTRUKSION”sh.p.k me NIPT K66613407H, me adresë në Dibër, Bulqizë, Lagja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati Nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur me mjete elektronike / Punë.

Numri i referencës së proçedurës: **REF 63019-03-20-2023**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45000000-7 -- Punë ndërtimi

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të zeza KUZ, fshatrat Gjoricë e Sipërme dhe Gjoricë e Poshtme Njesia Administrative Gjoricë.

Afati kohor për ekzekutimin: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Fondi limit: 249,066,402 (dyqind e dyzet e nëntë milion e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e dy) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, përkatësisht me NIPT K47103804L dhe NIPT K66613407H.

Vlera e Ofertës: 239,999,922.8 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy pikë tetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik Shoqëria “SIRETA 2F” sh.p.k NIPT K51501008J

Vlera e Ofertës: 246,583,589.7 (dyqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “KUPA” shpk NIPT K51615512C

Vlera e Ofertës: 247,736,622 (dyqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy lekë) lekë pa TVSH.

Oferta të refuzuara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “SIRETA 2F” sh.p.k me NIPT K51501008J, me vlerë të ofertës 246,583,589.7 (dyqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik, konstatoi se nuk plotëson:

Ky operator ekonomik nuk përmbush Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të kërkuar sipas Shtojcës 8 të DST-së, publikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nuk përmbush paragrafin 2.2.1 tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Kapitulli “Kapaciteti Ekonomik dhe financiar”, pasi nuk ka paraqitur bilancet për vitet 2020, 2021. Gjithashtu bilanci i vitit 2022 që është paraqitur nga ky operator ekonomik, rezulton i pakonfirmuar nga administrata tatimore.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.1 gërma a dhe 2.3.1 gërma b të kriterëve të veçanta të kualifikimit të Shtojcës 7 të DST-së, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” në lidhje me përvojën e suksesshme për punë të ngjashme, pasi natyra e punimeve është e ndryshme për disa kontrata dhe vlera e punëve të ngjashme është më e ulët nga sa kërkohet për plotësimin e këtij kriteri.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.2 gërma b të kriterëve të veçanta të kualifikimit për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi nuk ka paraqitur asnjë nga çertifikatat ISO të kerkuara në DST.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.2 gërma c pika 1,2,3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument siç kërkohet në DST përkatësisht Autorizim të Prodhuesit për materialet e kerkuara, kataloget përkatës të materialeve dhe deklaratën për standartet e menaxhimit të cilësisë së prodhuesit.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.3 gërma a, 2.3.3 gërma b, 2.3.3 gërma c, 2.3.3 gërma d, paragrafi 2.3.3 gërma e dhe 2.3.3 gërma f të kriterëve të veçanta të kualifikimit Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pasi nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” për makineri dhe pajisje, pasi nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” për afatin e kryerjes së punimeve pasi nuk ka paraqitur grafikun e punimeve të kërkuar në DST.

Sa më lart, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “SIRETA 2F”sh.p.k.**

2. Operatori Ekonomik “KUPA” sh.p.k, me NIPT K51615512C me vlere të ofertës: 247,736,622 (dyqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik konstatoi se nuk plotëson:

Nuk përmbush paragrafin 2.3.1 gërma a dhe 2.3.1 gërma b të kriterëve të veçanta të kualifikimit Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” në lidhje me përvojën e suksesshme për punë të ngjashme, pasi nuk ka paraqitur kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive për kontratën e ngjashme të paraqitur dhe të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.3 gërma b,c dhe d të kriterëve të veçanta të kualifikimit Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” në lidhje me kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për stafin që duhet të disponojë operatori ekonomik, pasi në licencën e shoqërisë figuron vetëm 1(një) inxhinier hidroteknik nga 2 të deklaruar në Shtojcën 8 mungon 1(një) teknik ndërtimi, 3 (tre) specialist karpentier, 3 (tre) specialist hidroizolues, 5(pesë) punonjes të specializuar për bashkimin e tubave, 4 (katër) hekurkthyes, nuk është deklaruar asnjë murator dhe mungojnë 4 (katër) manovratorë/eskavatorist/automakinist, duke mos përmbushur kërkesat e bera nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” në lidhje me makineritë dhe pajisjet, pasi nuk ka paraqitur makineritë: autobitumatrice, pajisjen e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes/prurjes (pajisja dixhitale), Sistemin Well Point, makineri teknologjike (trancher) për frezim dhe hapje kanali me thellësi mbi 50 cm në rrugë të asfaltuara si dhe vinc eskavator me krahë të gjatë me kapacitet ngritës mbi 60 ton i pajisur me ganxha dhe kullë vinci.

Sa më lart, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`**kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “KUPA” sh.p.k.**

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “**VIANTE KONSTRUKSION**” sh.p.k & “**LIS KONSTRUKSION**” përkatësisht me NIPT K47103804L me NIPT K66613407H, me vlerë të ofruar 239,999,922.8 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy pikë tetë) lekë pa TVSH.

Kualifikohet

Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “**VIANTE KONSTRUKSION**” sh.p.k & “**LIS KONSTRUKSION**”, Komisioni i Vleresimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, konkludon se ky Bashkim Operatorësh Ekonomikë plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimiit /Kualifikimit.

Ky Bashkim Operatorësh dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka te rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Gjithashtu plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “**VIANTE KONSTRUKSION**”sh.p.k & “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k, si dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.

Autoriteti Kontraktor në përfundim konkludoi:

Oferta të refuzuara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “**SIRETA 2F**” sh.p.k me vlerë të ofertës 246,583,589.7 (dyqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë shtatë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “**KUPA**” sh.p.k me vlere të ofertës: 247,736,622 (dyqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Oferta të kualifikuara:

Oferta e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “**VIANTE KONSTRUKSION**”sh.p.k & Shoqëria“**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k, me vlerë të ofruar prej 239,999,922.8 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy pikë tetë) lekë pa TVSH.

Duke u nisur nga renditja e operatoreve ekonomikë të kualifikuar, në bazë të kriterit të përzgjedhjes Çmimi më i ulët, konkludohet se Oferta fituese është oferta e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION”sh.p.k, përkatësisht me NIPT K47103804L dhe K66613407H, me vlerë të ofruar 239,999,922.8 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy pikë tetë) lekë pa TVSH.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k me NIPT K47103804L, me adresë në Elbasan Gramsh, GRAMSH, SPORTI dhe Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k me NIPT K66613407H me adresë në Dibër, Bulqizë, Lagja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati Nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë, se oferta e paraqitur me një vlerë totale 239,999,922.8 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy pikë tetë) lekë pa TVSH, / totali i pikëve të marra [_____]; është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a, me zyra në adresën Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë, Shqipëri, **sigurimin e kontratës**, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO

JO

